

L I G J
Nr.8068, datë 15.2.1996

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7572, DATË 10.6.1992 “PËR ORGANIZIMIN DHE
FUNKSIONIMIN E PUSHTETIT LOKAL”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Paragrafi i fundit i nenit 5 të ligjit nr.7572, datë 10.6.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal”, ndryshohet si vijon:

“Në rastet e shpërndarjes së këshillave lokale, si dhe të shkarkimit nga detyra të kryetarëve të bashkive e komunave, ngarkohet Këshilli i Ministrave të organizojë, jo më vonë se 6 muaj nga dita e shpërndarjes a shkarkimit të organeve të pushtetit lokal, zgjedhjet për këshillin ose kryetarin e ri. Këshilli i Ministrave cakton mënyrën e funksionimit të administratave lokale, organet përfaqësuese të të cilave janë shpërndarë a shkarkuar”.

“Në rastet e shkarkimit të kryetarit të bashkisë apo komunës funksionet e kryetarit do t’i kryejë përkatësisht nënkryetari i bashkisë apo komunës ose i deleguari i Këshillit Ministrave.

Në rastet e shkarkimit të kryetarit të këshillit të rrethit, funksionet e kryetarit, deri në zgjedhjen e kryetarit të ri të këshillit, i kryen nënkryetari i këshillit të rrethit. Këshilli i rrethit në praninë e një të deleguari të Këshillit të Ministrave duhet të mblidhet e të zgjedhë kryetarin e ri, jo më vonë se 15 ditë nga data e shkarkimit të kryetarit. Në rast se këshilli i rrethit nuk arrin të zgjedhë kryetarin e tij, Këshilli i Ministrave shpërndan këshillin dhe cakton një të deleguar të tij për funksionimin e administratës, sipas dispozitave të këtij ligji”.

Neni 2

Paragrafi i dytë i nenit 21 ndryshohet si vijon:

“Aktet që kanë të bëjnë me buxhetin, vendosjen e detyrimeve dhe të taksave lokale, administrimin e pasurisë të komunës ose të bashkisë, me organizimin e zhvillimin urbanistik dhe për shoqëritë e përbashkëta me këshillat e tjera ose firma të brendshme a të jashtme, kur nuk miratohen nga këshilli, miratohen nga prefekti mbi bazën e propozimit të motivuar të kryetarit të bashkisë, komunës a këshillit të rrethit, vetëm pasi prefekti ka marrë paraprakisht miratimin nga Sekretari i Shtetit për Pushtetin Lokal.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekreten nr.1382, datë 23.2.1996 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha